



Planuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Received/Delivery	13.12.2021	viti god year	2021
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SI-MBKK	6056/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.901/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bektoshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.901/2021 të datës 03.11.2021 e parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga "Hamdi Beha", Nr.108, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/lëshim i akt emërimit", kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.12.2021, mori këtë

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.901/2021 e datës 03.11.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas akt emërimit të datës 01.03.2016 me numër 565/16 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare Ligjore", sipas vendimit të datës 09.08.2019 me numër 496/2019 ri caktohet nga pozita "Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë" me koeficient shtatë (7) ri caktohet në pozitën e njëjtë ekuivalente të lirë "Referente e Lartë" në Gjykatën Themelore në Prishtinë me koeficient shtatë (7) duke filluar nga data 01.08.2019.

Ankuesja me datë 20.01.2020 parashtron kërkesë në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kërkesën për lëshim të akt emërimit sipas vendimit për ri caktim të datës 09.08.2019 ankuesja pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj me datë 27.07.2021 me numër 01/513 e njofton Kryesuesin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, se përmes e-mail-it me datë 14.07.2021 U.d Administratori ka kërkuar që të angazhohet në punë në gjykatë konform akt emërimit të saj si sekretare/ juridike, përkundër faktit se ankuesja e ka vendimin për ri caktim të datës 09.08.2019 me numër 496/2019, pastaj ankuesja me datë 23.09.2021 me numër 03/1942 ka parashtruar kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës me të

cilën kërkesë ka kërkuar që ti lëshohet akt emërimi sipas dispozitivit III të vendimit numër 496/2019 të datës 09.08.2019, pasi që ankuesja nuk ka marrë përgjigje lidhur me kërkesat e saj me datë 03.11.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër 5265/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 08.11.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli më datë 08.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/18.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 03.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimi i datës 10.07.2019 për përvojë të punës; Kërkesa e ankueses e datës 20.01.2020 e parashtruar në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi mbi ri caktimin e nëpunësit civil i datës 09.08.2021 me numër 496/2019; e-mail i datës 14.07.2021; Njoftimi i datës 27.07.2021 nga ankuesja për Kryesuesin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesa e datës 23.09.2021 e parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Kopja e letër njoftimit të ankueses; Njoftimi i datës 12.10.2021 me nr. të referencës DS-56612021; Ankesa me numër 132/2021 e datës 23.09.2021 e Institucionit të Avokatit të Popullit; Akt emërimi i ankueses i datës 01.03.2016; Diploma e ankueses e datës 19.09.2015 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/18.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses
është e pa lejuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja me datë 21.01.2020 me numër 03/60 ka parashtruar kërkesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me pretendim ankimor që konform Vendimit mbi ri caktim të nëpunëses civile të datës 30.07.2019 të protokolluar me datë 09.08.2019 me të cilin është ri caktuar nga pozita "Zyrtare Ligjore" në Gjykatën Themelore në Prishtinë në pozitën e njëjtë ekuivalente të lirë "Referente e Lartë" në Gjykatën Themelore në Prishtinë, që ti lëshohet akt emërimi si pas këtij vendimi, ankuesja pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj të datës 21.01.2020 përsëri bënë kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës me datë 23.09.2021 me numër 036/19425 për lëshim të akt emërimit sipas vendimit mbi ri caktim me numër 496/2019 të datës 09.08.2021.

Ankuesja pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj të datës 03.11.2021 parashtron ankesë me numër të protokollit 5265/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor që ti lëshohet akt emërimi sipas Vendimit mbi ri caktim me numër 496/2019 të datës 09.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesja dhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesja me datë 03.11.2021 ka



parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit sepse nuk ka parashtruar ankesë në organin e punësimit respektivisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me pretendim ankimor për mos lëshim të akt emërimit sipas Vendimit mbi ri caktim të datës 09.08.2021 me numër 496/2019, andaj Kolegji konstaton në këtë rast ankuesja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se *"2.Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave" dhe 2.2 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar se nëpunësi civil para parashtrimit të ankesës në Këshill, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe, po ashtu edhe me dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka përcaktuar se: *"1. Paraqitja e ankesës bëhet me shkrim, e cila dorëzohet në njësinë e personelit", si dhe "2. Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.901/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Menaxheres së Personelit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.